



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 19 të Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JOFINANCIARE TË
KOMUNËS

I. Për inventarizimin e pasurive jofinanciare të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje:

1. Burim Gashi, Kryesues
2. Gafurr Hetemi, anëtar
3. Ramiz Gashi, anëtar
4. Ismet Haziri, anëtar
5. Behar Aliu, anëtar

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me Rregulloren nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon :

1. Të inventarizoj të gjithë pasurinë jofinanciare që është në pronësi dhe kontroll të Komunës,
2. Të bëjë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes të pasurisë jofinanciare ,
3. Të bëjë krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jofinanciare,
4. Të identifikojë pasurinë që nuk ka vlerë të bartur,
5. Të identifikojë pasuritë e dëmtuara dhe jashtë përdorimit

III. Përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit

Komisioni pas kryerjes së inventarizimit duhet të hartoj dhe prezentoj raportin për inventarizimin e pasurisë jofinanciare më së largu deri me datë 15 Janar 2023.

IV. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 020/04-50267
Lipjan, më 20.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

